




KOMUNA RAHOVEC



RAPORT NËNTËMUJOR I PUNËS

JANAR – SHTATOR 2024

Zyra e Kryetarit Adresa: Rr. 8 Dëshmorët e Pashtrikut p.n, 21000, Rahovec –Kosovës Tel: 0382004534

RAPORT GJASHTËMUJOR I PUNËS

PËRMBAJTJA

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE.....	1
PËRFUNDIM.....	2

Raport gjashtë mujor

Hyrje

Raporti pasqyron të gjitha aktivitetet dhe angazhimet e drejtorisë së shërbimeve publike në Komunën e Rahovecit, njëkohësisht reflekton angazhimin dhe rezultatet e shënuara në këtë periudhë.

Ky raport gjithëpërfshirës ka për qëllim të nënvizojë, progresin e arritur në realizimin e prioritetëve të Komunës dhe ka si pikë reference Programin e Qeverisë Komunale.

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

Drejtoria për Shërbime Publike, në bazë të Statutit të Komunës së Rahovecit dhe rregulloreve në fuqi, Planit të Punës për vitin 2024, përkundër sfidave dhe vështirësive ka përfunduar me sukses një sërë projektesh dhe ka realizuar një mori aktivitetesh përgjatë kësaj periudhe gjashtëmujore.

Në vazhdim DSHP ka raportuar për aktivitetet kryesore që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe.

Aktivitetet në periudhën: janar, shkurt, mars 2024

- Është përfunduar sipas ligjit të ri vlerësimi i punëtorëve për gjatë kësaj periudhe, deri me 31 janar
- Ka pasur aktivitete me 3 kompanitë e kontraktuar nga Komuna e Rahovecit, në menaxhimin sa më të mirë të mirëmbajtjes së rrugëve dimërore, përveq pastrimit të rrugëve nga bora, kompanitë janë angazhuar në pastrimin e rrugëve nga mbeturinat,
- Është bërë krasitja e drunjëve dekorativ në qytet dhe vendbanime tjera,
- Ka filluar ndërtimi i pritoreve për pritjen e udhëtarëve në qytet dhe pikat që janë përcaktuar në vendbanimet e komunës së Rahovecit,

RAPORT GJASHTËMUJOR I PUNËS

- Po vazhdon projekti i zgjerimit të kanalizimit sipas prioriteteve, janë perfunduar kanalizimet në lagje Vllezerit Frasheri, Dejn, Cifllak, Rahovec,
- Po vazhdon mirëmbajtja e rrugëve në zonën urbane, në përmirësimin e ujëmbledhësve dhe gropave të krijuara në rrugë,
- Jemi në ndërtim të sipërm pritoreve të vendalimeve për udhëtarë në 16 pozicione, ku përveq elementeve të tjera si orari, harta, pika e ndalimit do të vendosen edhe hapësirat për persona të hendikuar,
- Gjatë kësaj periudhe janë bërë disa ndërhyrje në rregullimin e disa problemeve me ndriçim publik, poashtu ka pasur aktivitete në zgjerimin e ndriçimit publik, janë përfunduar vendbanimet Reti, Reti e Ulet, Polluzhe dhe Zatriq,
- Kemi angazhuar stafin në bashkërendimin me drejtoritë të tjera në detyrat që janë dhënë në lirin e hapësirave publike dhe inkasimin e mjeteve në shfrytëzimin e këtyre pronave,
- Është bërë marrëveshja e re me KRU Gjakovën, për investime të përbashkëta publike,
- Kemi lidhur kontrate për zgjerimin e kamerave që përfshin fazën e dytë rrugën tranzite dhe fshatin Hoqë e Madhe, takime me donatorin JICA për reformat në menaxhim të mbeturinave,
- Janë përfunduar disa segmente rrugore në disa vendbanime, Gur i Kuq 5 rrugë, Sapniq, 6 rrugë, Pataqan i Poshtëm 5 rrugë, Paqtan I Epërm 2, Nashpall 2, Ratkoc 7, Rahovec 2, Cifllak 5, Nagac 1, Brestoc 2 dhe në Zaqishtë 3 segmente,
- Kanë filluar punimet në qytet nga kompania e kontraktuar, aktualisht punimet janë duke u zhvilluar në rrugën "Gzim Hamza-Piktori", në vendosjen e kanalit atmosferik dhe zëvendësimin e gypit për ujë të pijshëm,
- Është bërë barazimi i rregullt i të hyrave në drejtori,
- Ka filluar mirëmbajtja e hapësirave publike, janë eliminuar në këtë periudhë të gjitha deponitë ilegale të mbeturinave, pastrimi i hapësirave publike,
- Ka filluar ndërtimi i trotuareve në vendbanimet, Sapniq, Drenoc, Fortesë dhe Brestoc.

Aktivitetet në periudhën: prill, maj, qershor 2024

- Edhe në këtë periudhë ka pasur vazhdimisht mirëmbajtje të hapësirave publike, vetëm është duke vazhduar pastrimi çdo ditë kemi aktivitete në teren, në mirëmbajtje të rrugëve dhe trotuareve, po ashtu ka filluar pastrimi i hapësirave publike, duke përfshirë varrezat civile, lapidare,

RAPORT GJASHTËMUJOR I PUNËS

- Ka filluar projekti i ndriçimit publik, gjate jave se kaluar janë përfunduar 5 rrugë ne qytet, do te vazhdon projekti smart edhe ne vendbanime dhe lagje te tjera,
- Deponite ilegale, ky aktivitet ka vazhduar edhe ne mirëmbajtjen e rrugëve rajonale si Rahovec-Malisheve,
- Ka filluar projekti i ndërtimit te kanalit te kullumit ne fshatin Dejn,
- Është përfunduar projekti i ndërtimi dhe zgjerimit te kanalizimeve ne Dejn,
- Sa i përket rrugës 4 korsi, sfide kemi pasur me nje loto ku eshte nderprere lot 1 ku përfshin nga kompania Termositem Osa deri ne Xerxe, jemi ne procedure te rishpalljes, ndërsa po vazhdojnë punimet me kompaninë Euroasfalt dhe Mendi-P,
- Kemi nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi ne mes te komunës dhe M. Infrastrukturës per nje projekt tjetër per asfaltimin e rrugës Sapniq-Nashpall.

•

• Aktivitetet në periudhën: korrik, gusht, shtator 2024

- Në sinjalizim vertikal dhe horizontal kemi pasur aktivitete me drejtoritë tjera për vendosjen e shenjave shtese ne disa pozicione si ne qendër apo ne vende te tjera,
- Kemi përfunduar disa pozicione për rregullim te puseatve dhe gropave ne qytet, do te vazhdon projekti,
- Po ashtu jemi duke punuar ne kanalin e ujerave atmosferik ne DEJN,
- Me deponi ilegale qëndrojmë mire, ne rrugët rajonale ne hyrjet e qytetit dhe ne komunën tone nuk ka me deponi ilegale, te gjitha mirëmbahen nga kompanitë e kontraktuara,
- Jemi duke punuar me larje te rrugëve, ujitjen e drunjtëve si dhe ujitjen e parqeve ne disa vende, janë bere pastrimet edhe ne lumin Duhlllo,
- Ka përfunduar ndërtimi i kanalizimit ne lagjen Vëllezërit Frasheri,
- Kompania Benita, ka përfunduar asfaltimin e rrugës Gezim Hamza, ne gjatësi prej 1 km, vazhdon pjesën tjetër,
- Ne kete periuduhe ka perfunduar ndërtimi i trotuareve ne Fshatin Brestoc, ka përfunduar ndërtimi i trotuarit ne fshatin Hoqe e Vogël,
- Sa i përket rrugës 4 korsi dy kompanitë janë duke punuar, Euro asfalt dhe kompania Mendi-P po bëjnë pergaditjet e fundit per asfaltimin e rrugës,
- Ne ndriçim publikne kete periudhe janë bere zëvendësimet e poqave te ndriçimit publik sipas kontratës ESCO,
- Me projektin IPA si partnere me bashkimin evropian, komuna e Rahovecit eshte duke ndërtuar 6 gropa bio-septike, Polluzhe, Reti, Rahoveci 1, Patqan i Poshtem, Pataqan Eperm dhe Pastasel,

RAPORT GJASHTËMUJOR I PUNËS

- Ne ndriçim publik, sipas kontratës ESCO janë bere zëvendësimi i poqave ne 7 vendbanime gjithsej 988 poqa elektrik, ndërsa me zgjerime kemi pasur zëvendësime ne disa rruge ne kuadër te kontratës për mirëmbajtje, etj...
- Kane përfunduar disa rruge ne fshatin Zaqisht, janë përfunduar 4 segmente rrugore,
- Kane përfunduar punimet ne dy segmente rrugore ne fshatin Kramavik,
- Po vazhdon puna me lot 2 me kompaninë Euroasfalt, po ashtu edhe me kompaninë Mendi P ne rrugën 3 korsi,
- Janë përfunduar dy mure mbrojtëse ne qytet, ne dy lagje,
- Ka pasur edhe aktivitete te pastrime te kanaleve, te rrugëve, te riparimeve te disa shaktave, etj.
- Kemi intervenuar ne disa rruge ne qytet, ne riparimin e disa gropave,
- Është rehabilituar me beton pjesa e mbetur e kanalizimit ne rrugën Vëllezërit Frashëri,
- Ne bashkëpunim me KRU Gjakoven po punojmë ne ndërtimin e projektit te ujesjellesit, ne dy projekte: Rahovec-Zona ekonomike si dhe ne projektin Ratkoc-Vrajak-Bratatin,
- Ne ketë jave është mbajtur ne Shkup një takim lidhur me projektin IPA se bashku me partner nga komuna e Haraqines, Maqedoni e Veriut.

Sfidat e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për vitin 2024 janë:

- Sfidat e drejtorisë do të jenë mundësitë buxhetore që kemi si drejtori, kemi shumë kërkesa për ndërtimin e rrugëve lokale të rrugëve dytësore dhe të pa kategorizuara;
- Kërkesa të vazhdueshme për ndërtim të trotuareve; mbeturinat e amvisërisë që fatkeqësisht hidhen kudo, vend e pa vend ku krijohen deponitë ilegale;
- Furnizimi me ujë të pijshëm për ato vende që ende nuk kanë të shtrirë rrjetin e KRU Gjakovës si dhe kërkesat e shumëta për zavendsimin e gypave të rinjë të azbestit.

Përfundim

Ky raport përmbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe raportuese.

Ju faleminderit!

Rahovec, 10 qershor 2024

RAPORT GJASHTËMUJOR I PUNËS

- Ne ndriçim publik, sipas kontratës ESCO janë bere zëvendësimi i poqave ne 7 vendbanime gjithsej 988 poqa elektrik, ndërsa me zgjerime kemi pasur zëvendësime ne disa rruge ne kuadër te kontratës për mirëmbajtje, etj...
- Kane përfunduar disa rruge ne fshatin Zaqisht, janë përfunduar 4 segmente rrugore,
- Kane përfunduar punimet ne dy segmente rrugore ne fshatin Kramavik,
- Po vazhdon puna me lot 2 me kompaninë Euroasfalt, po ashtu edhe me kompaninë Mendi P ne rrugën 3 korsi,
- Janë përfunduar dy mure mbrojtëse ne qytet, ne dy lagje,
- Ka pasur edhe aktivitete te pastrime te kanaleve, te rrugëve, te riparimeve te disa shaktave, etj.
- Kemi intervenuar ne disa rruge ne qytet, ne riparimin e disa gropave,
- Është rehabilituar me beton pjesa e mbetur e kanalizimit ne rrugën Vëllezërit Frashëri,
- Ne bashkëpunim me KRU Gjakoven po punojmë ne ndërtimin e projektit te ujesjellesit, ne dy projekte: Rahovec-Zona ekonomike si dhe ne projektin Ratkoc-Vrajak-Bratatin,
- Ne ketë jave është mbajtur ne Shkup një takim lidhur me projektin IPA se bashku me partner nga komuna e Haraqines, Maqedoni e Veriut.

Sfidat e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për vitin 2024 janë:

- Sfidat e drejtorisë do të jenë mundësitë buxhetore që kemi si drejtori, kemi shumë kërkesa për ndërtimin e rrugëve lokale të rrugëve dytësore dhe të pa kategorizuara;
- Kërkesa të vazhdueshme për ndërtim të trotuareve; mbeturinat e amvisërisë që fatkeqësisht hidhen kudo, vend e pa vend ku krijohen deponitë ilegale;
- Furnizimi me ujë të pijshëm për ato vende që ende nuk kanë të shtrirë rrjetin e KRU Gjakovës si dhe kërkesat e shumëta për zavendsimin e gypave të rinjë të azbestit.

Përfundim

Ky raport përmbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe raportuese.

Ju faleminderit!

Rahovec, tetor 2024


Përparim Krasniqi
Drejtore i Shërbimeve Publike